

Co-funded by  
the European UnionCHAMBER OF INSTALLATION SPECIALISTS IN  
BULGARIA - "TOGETHER WE CAN DO MORE"EUROPEAN  
LABOUR  
INSTITUTESUSTAINABLE  
DEVELOPMENT AND  
ENVIRONMENT ASSOCIATION

## PARTNERITETI I AFP-SË PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË GJELBËR DHE INTELIGJENTE NË NDËRTESA. - VET4GSEB

Projekti VET4GSEB synon të transferojë përvojën dhe praktikën e mira në fushën e arsimit dhe formimit profesional nga vendet evropiane (Bullgaria dhe Turqia) në vendet e tjera pjesëmarrëse në projekt, përkatësisht Shqipërinë, Ukrainën, Armeninë dhe Gjeorgjinë. Megjithatë, ajo që është më me vlerë është ndarja dhe njohja e ideve ndërmjet të gjithë partnerëve.

Qëllimi i VET4GSEB është të pajisë ofruesit e AFP-së me zgjidhje të përshtatura, materiale trajnimi, mjete dhe udhëzime në mënyrë që t'u mundësojë atyre të përditësojnë dhe përmirësojnë programet dhe praktikën e tyre të trajnimit.

### HISTORIKU ÇFARË KEMI ARRITUR DERI TANI?

Objektivat dhe synimet e vendosura në Strategjinë dhe politikat e BE-së për Energjinë dhe ato të vendeve pjesëmarrëse kanë çuar në ndryshime në tregun e punës për projektuesit dhe instaluesit e aplikacioneve "të zgjuara" dhe sistemeve të energjisë së rinovueshme në ndërtesa. Sektori ka nevojë për profesionistë me aftësi të reja - jo vetëm njohuri dhe aftësi në fushën e instalimeve "të zgjuara" të ndërtesave dhe sistemit të BRE, por edhe kompetenca të buta, ndërpersonale, sipërmarrëse..

Jemi të lumtur të ndajmë të rejtat më të fundit mbi projektin tonë VET4GSEB. Këtu janë arritjet tona të fundit:

1. Raport mbi **Nevojat e Tregut të Punës** për elektrikistë dhe instalues të sistemeve të BRE në ndërtesa.
2. Ekipi ynë ka përgatitur një raport të gjerë mbi **Metodologjitë më të Mira të Trajnimit** për të pajisur profesionistët me aftësitë e nevojshme
3. **Mbledhja e të dhënave mbi zgjidhjet inovative teknike** për zbatimin e instalimeve elektrike inteligjente dhe sistemeve PV në ndërtesa.
4. Është përpiluar një **Raport mbi Zgjidhjet e Reja për Aplikacionet PV.**

Të gjitha materialet mund t'i gjeni në:

[www.vet4gseb.eu](http://www.vet4gseb.eu)



## Çfarë ka ndodhur deri tani?



**Takimi i tretë i partnerëve** u mbajt në **Tbilisi, Gjeorgji** 🇬🇪 më 28-29 shtator 2023, organizuar nga EECG dhe morën pjesë përfaqësues të ndryshëm të konsorciumit, fizikisht dhe online. Diskutimet kryesore përfshinin raportet e progresit, kurrikulën për programin e trajnimit, veçoritë e platformës së rrjetëzimit në internet, strategjitë e shpërndarjes dhe ndikimit, si dhe planifikimin e aktiviteteve deri në mesin e vitit 2024.

**Përfundimi i Moduleve dhe Fillimi i Kursi në Internet:** Të gjitha modulet e trajnimit janë përfunduar dhe gjenden online.

**Kursi ynë për ofruesit e AFP-së në fushën e BRE-ve** është i disponueshëm në faqet tona. Ky kurs është falas dhe mund të zhvillohet në mënyrë të pavarur. Palët e interesuara mund të regjistrohen dhe të përfundojnë kursin me ritmin e tyre dhe të marrin certifikimin pas kalimit të testeve.



**Takimi i Partnerëve në Bursa, Turqi** 🇹🇷: Më 27 qershor 2024, të gjithë partnerët e konsorciumit u mbledhën në Bursa, Turqi, për të diskutuar mbi qëndrueshmërinë e projektit dhe përmirësimet e mundshme.



## Trajnimi Ndërkombëtar i Trajnerëve në Bursa, Turqi:

Pjesën e fundit të trajnimit tonë pilot e mbajtëm fizikisht në datat 25-26 qershor në Bursa, Turqi. Fokusi ishte në energjinë e rinovueshme, panelet diellore dhe instalimet elektrike. Duke përdorur metoda inovative trajnimi dhe teknologji dixhitale, kjo nismë synon të kapërcejë hendekun midis arsimit aktual profesional dhe sektorit të energjisë së gjelbër, duke i pajisur pjesëmarrësit me kompetenca të reja dhe aftësi të buta për një të ardhme të qëndrueshme.

## Çfarë do ndodhë më pas?

- Trajnimi Kombëtar i Trajnerëve në 6 vende (Bullgaria, Shqipëria, Armenia, Turqia, Gjeorgjia, Ukraina)



<https://vet4gseb.eu/>

Platforma e trajnimit

<https://vet4gseb.eu/training-platform/>



[sec@sec.bg](mailto:sec@sec.bg)